



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:092255
Datë: 12.08.2024
Numri i dokumentit: 06040781

CAP.nr.1574/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A (në vijim KEDS), kundër debitorit R. Sh nga Gjilani, me objekt të përmbarimit kërkesë në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.25/2023 i datës 12.05.2023, me datë 12.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit R. Sh nga Gjilani, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, CPK.nr.25/2023 i datës 12.05.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CPK.nr.25/2023 i datës 12.05.2023, ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e datës 04.04.2023, të debitorit R. Sh nga Gjilani, të paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor, P.nr.101/23 të datës 21.03.2023 të përmbaruesit privat Besnik F. Nuhiu, dhe i njëjti urdhër mbetet në fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor kanë parashtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktvendimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet propozimi për përmbarim apo rasti të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208, 209 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me Urdhrin e Përmbauesit Privat Besnik F. Nuhiu me seli në Gjilan P.nr.101/23 të datës 21.03.2023, është caktuar përmbarimi në dobi të kreditorit Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) Sh.A. Prishtinë, ndaj debitorit R. Sh nga Gjilani, në bazë të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.268/2018 të datës 08.11.2018, i plotfuqishëm me datë 10.12.2018 dhe i ekzekutueshëm në të njëjtën datë, për realizimin e kërkesës në të holla në shumë prej shumë prej 519.63 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbaimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, duke theksuar borxhi për të cilin është lejuar përmbarimi është i parashkruar, sepse ka kaluar çdo afat ligjor për të kërkuar përmbushjen e të njëjtit. Andaj ka kërkuar nga gjykata që të aprovojë prapësimin si të bazuar dhe të shfuqizojë urdhrin përmbaimit dhe të përfundojë procedurën.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se e kundërshton në tërësi prapësimin e ushtuar nga debitori, pasi që i njëjti është i pa argumentuar dhe pa asnjë provë, e gjithashtu sa i përket pretendimit se borxhi është parashkruar, ky pretendim nuk qëndron pasi që në përputhej me nenin 361 të LMD-së, shprehimisht përcaktohet se “Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”. Andaj meqë i njëjti nuk ka ndërmarrë veprimet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ka kërkuar nga gjykata që urdhri përmbaimit të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin CPK.nr.25/2023 të datës 12.05.2023 ka refuzuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se prapësimi i debitorit i datës 04.04.2023, është i pabazuar, pasi që i njëjti nuk ka vërtetuar shkakun e paraparë të nenit 71 të LPP-së, për paraqitjen e prapësimin, e gjithashtu gjeti se aktgjykimi me të cilin është lejuar përmbarimi është dokument i përshtatshëm për përmbaimit, duke u bazuar në nenin 22 të LPP-së: dokumente përmbauese janë: “vendimi përmbaues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbauese” e në rastin konkret gjykata vlerësoi se kërkesa e kreditorit për përmbushje të kompensimit, në bazë të dokumentit përmbaues (Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.268/18 i datës 08.11.2018) të cilit ia ka bashkangjitur propozimit, është dokument i përshtatshëm për përmbaimit.

Gjykata e shkallës së parë për mënyrën e vendosjes vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitat e nenit 5, 22, 71, 73 të LPP-së, dhe në nenin 361 të LMD-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjiilan C.nr.268/2018 i datës 08.11.2018, i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm me datë 10.12.2018, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.1 të LPP-së, e cila përcakton së: “dokument përmbarimor është vendimi përmbarues i gjykatës dhe ujdia gjyqësore përmbaruese” dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 dhe 27 paragrafi 1, i po këtij ligji ku përcaktohet se: “dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave ligjore me rastin e refuzimit prapësimit nuk qëndrojnë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit se në rastin konkret është arritur parashkrimi, kjo për faktin se me nenin 361 të LMD-së parashihet: “Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim”.

Pretendimet e debitorit për vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbarimore Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke iu përmbajtur parimit të rigorozitetit formal-juridik, që nënkupton se Gjykata do të vlerësojë shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera që i përkasin procedurës në të cilën është nxjerr dokumenti përmbarimor.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit por të cilat nuk kanë qenë me rëndësi vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë dhe se për këtë arsye gjykata ankimore ka vendosur që t’i refuzojë ndërsa aktvendimin e ankimuar ta vërtetoj.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se “në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1574/2023, me datë 12.08.2024

Gjyqtarja,
Frosina Sylejmani